

TURIZMI NË SHIFRA PËR VITIN 2017

PERMBAJTJA :

1. TË DHËNAT PËR VIZITORËT E HUAJ TË HYRË PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2017	2
1.1 TË DHËNAT PËR VIZITORËT TË GRUPUAR SIPAS KONTINENTEVE	3
1.2. NUMRI I VIZITORËVE TË HUAJ, SIPAS MËNYRËS SË UDHËTIMIT	4
1.3. HYRJET E SHTETASVË TË HUAJ NË SHQIPËRI SIPAS QËLLIMIT TË UDHËTIMIT	5
2. TURIZMI KULTUROR NË SHQIPËRI GJATË VITIT 2017	6
3. TURIZMI NË ZONAT E MBROJTURA	7
4 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA TURIZMI	8
4.1 KONTRIBUTI I INDUSTRIË SË TURIZMIT	9
4.1.1 KONTRIBUTI DIREKT NË PBB	9
4.1.2 KONTRIBUTI TOTAL NË PBB	10
4.1.3 KONTRIBUTI DIREKT NË PUNËSIM	10
4.1.4 KONTRIBUTI TOTAL NË PUNËSIM	11

1. TË DHËNAT PËR VIZITORËT E HUAJ TË HYRË PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2017

Bazuar në të dhënat zyrtare të Institutit të Statistikave raportohet se gjatë vitit 2017 në Shqipëri kanë hyrë gjithsej 5.117.700 vizitorë të huaj. Në këtë numër nuk përfshihen shtetasit e huaj, të cilët kalojnë tranzit në vendin tonë.

Për këtë periudhë numri i vizitorëve të huaj ka një rritje prej 8 % krahasuar me vitin 2016.

Nr.	PERIUDHA	VIZITORË TË HYRË	
		2016	2017
1	Vjetor	4.735.511	5.117.700

Tabela 1: Hyrjet e vizitorëve të huaj, për vitet 2016-2017(INSTAT)

Nga të dhënat për vizitorët, të grupuar sipas shteteve, për vitin 2017 vihet re se numri më i madh i vizitorëve të huaj që viziton vendin tonë vijon të kryesohet nga vizitorët me kombësi Kosovare. Kështu vizitorët nga Kosova për këtë vit përbëjnë 33.6% të hyrjeve kundrejt totalit, më pas ndiqen nga Maqedonia e Greqia, pra vendet e rajonit janë vendet kryesuese të kësaj liste.


Në tabelën e mëposhtme renditen 15 vendet me numrin më të lartë të vizitorëve që përzgjedhin vendin tonë.

Nr.	Shteti	Numri i vizitorëve	Përqindja kundrejt totalit
1	Kosovë	1.745.973	33.6%
2	Maqedoni	671.570	12.9%
3	Greqi	489.172	9.4%
4	Mal i Zi	380.988	7.3%
5	Itali	363.344	7%
6	Angli	127.333	2.45%
7	Gjermani	121.604	2.3%
8	Poloni	114.582	2.2%
9	SHBA	97.786	1.9%
10	Turqi	79.639	1.5%
11	Serbi	63.785	1.2%
12	Zvicër	54.051	1%
13	Francë	52.428	1%
14	Bullgari	40.488	0.78%

15	Kroaci	24.443	0.47%
----	---------------	---------------	--------------

Tab 2: Numri i vizitorëve sipas shteteve gjatë vitit 2017(INSTAT).

Për të pasur më të qartë trendin e vizitorëve nga këto 15 vende po paraqesim në mënyrë grafike të dhënat për vitin 2016 krahasuar me 2017.



Grafik 1. Perpunoj MTM

Pra siç shihet dhe nga paraqitja grafike kemi një rritje të numrit të vizitorëve nga Greqia, Mali i Zi, Italia, Anglia dhe kemi ulje të numrit të vizitorëve nga Kosova e Maqedonia.

1.1 TË DHËNAT PËR VIZITORËT TË GRUPUAR SIPAS KONTINENTEVE

Gjatë këtij viti ka patur një rritje të numrit të vizitorëve nga disa prej tregjeve të synuara përtej kontinentit European. Përmendim këtu rritjen e numrit të vizitorëve nga kontinenti Afrikan, shifër që kap një vlerë 93% më shumë se numri i vizitorëve nga ky kontinent një vit më parë.

Gjithashtu fakt pozitiv është rritja e vizitorëve nga Evropa Veriore dhe Qëndrore. Në trendin krahasimor të vizitorëve nga viti 2016 me vitin 2017 vihet re ulje vetëm nga vizitorët e Evropës Juglindore, por dhe kjo është në një vlerë mjaft e moderuar -1.1% vizitorë më pak se viti 2016.

Tabela më poshtë jep trendin e vizitorëve sipas shtetit krahasuar me vitin 2016:

	2016	2017	↑ %
AFRIKA	1,077	2,080	93%
AMERIKA	103,839	123,729	19%
AZIA LINDORE DHE PAQËSORI	35,894	53,533	49%
LINDJA E MESME	4,274	4,722	10%
AZIA JUGORE	1,694	2,216	30%
EUROPA	4,485,405	4,689,400	4.5%
EUROPA QËNDRORE/LINDORE	182,581	270,885	48%
EUROPA VERIORE	149,965	204,099	36%
EUROPA JUGORE	3,855,617	3,810,337	↓ -1.1%
EUROPA PERËNDIMORE	221,492	316,120	43%
EUROPA LINDORE/MESDHETARE	75,750	86,878	14.6%
RAJONE TË PASPECIFIKUARA	103,328	244,725	136%
GJITHSEJ	4,735,511	5,117,700	8%

Tab 3: Numri i vizitorëve

sipas shteteve gjatë vitit 2017 (INSTAT)

1.2. NUMRI I VIZITORËVE TË HUAJ, SIPAS MËNYRËS SË UDHËTIMIT

Një nga të dhënat statistikore të raportuara nga Ministria e Brendëshme, e cila ndihmon në vendimmarrje të ndryshme është dhe mënyra e transportit që vizitorët zgjedhin për të ardhur në vendin tonë. Nga të dhënat për vitin 2017 rezulton se numri më i madh i vizitorëve vjen nga pikat kufitare tokësore, e më pas kryeson transporti ajror dhe vëndin e fundit e mban numri i vizitorëve që zgjedhin si mënyrë transporti detin. Raporti i vizitorëve të huaj të hyrë gjatë vitit 2017 sipas mënyrës së transportit, i shprehur në %, është si më poshtë:

- 81,1% e udhëtarëve kundrejt vlerës totale, zgjedhin rrugën tokësore;
- 11,4% zgjedhin rrugën ajrore dhe;
- 7,4% në rrugë detare

Nr.	Mënyra e udhëtimit	Periudha	
		2016	2017
1	Me ajër	456,931	577,844

2	Me det	275,574	393,013
3	Me tokë	4,003,006	4,146,843
GJITHSEJ		4,735,511	5,117.700

Tab 4: Numri i vizitorëve të hyrë sipas mënyrës së udhëtimit (INSTAT)

1.3. HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ NË SHQIPËRI SIPAS QËLLIMIT TË UDHËTIMIT

Nga të dhënat e 2017, vëmë re se numri i vizitorëve, të cilët kanë deklaruar se vijnë për pushime është rritur në vlerën 24% krahasuar me vizitorët e ardhur me pushime në Shqipëri gjatë vitit 2016.

	2016	2017
Gjithsej	4,735,511	5,117,700
I. Personale	4,676,762	5,049,173
Pushime	1,919,160	2,371,503
Vizitë në të afërm	18,299	18,766
Vizitorë ditorë	507,078	292,978
Trajtim shëndetësor	663	634
Qëllime fetare	1,034	601
Vizitorë të tjerë	2,071,955	2,182,594
Tranzit	158,573	182,097
II. Biznes dhe profesionale	58,749	68,527

Tab 5: Hyrjet e vizitorëve sipas qëllimit të udhëtimit (INSTAT)

2.TURIZMI KULTUROR NË SHQIPËRI GJATË VITIT 2017

Ministria e Kulturë nga të dhënat e mbledhura nga zyrat e informacionit të të gjitha pikave kulturore të vendin tonë, të cilat administrohen nga ky institucion, raporton se gjatë vitit 2017, numri i vizitorëve si të huaj dhe ai vendas, në atraksionet kulturore, është 669,110 vizitorë, 23% më shumë krahasuar me vitin 2016.

Destinacionet më të vizituara kulturore nga vizitorë të huaj janë vendet e Trashëgimisë Botërore si parku arkeologjik i Butrintit, Beratit dhe Gjirokastra, Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë, Parku Kombëtar Arkeologjik i Apolonisë dhe atraksionet kulturore të Korçës dhe Shkodrës. Numri i vizitorëve sipas institucioneve kulturore i gjeni në tabelën më poshtë:

Nr.	EMËTIMI I INSTITUCIONIT	NR. I VIZITORËVE
1	MUZEU HISTORIK KOMBËTAR TIRANË	54,610
2	MUZEU ARKEOLOGJIK DURRËS	11,133
3	MUZEU I PAVARSISË VLORË	5,603
4	MUZEU GJERGJ KASTRIOTI, KRUJË	31,361
5	MUZEU ETNOGRAFIK, KRUJË	15,238
6	MUZEU ETNOGRAFIK BERAT	6,450
7	MUZEU IKONOGRAFIK ONUFRI, BERAT	34,606
8	MUZEU I ARTIT MESJETAR, KORÇË,	10,418
9	MUZEU ARKEOLOGJIK, KORÇË,	1,220
10	MUZEU ARSIMIT, KORÇË,	14,418
11	MUZEU K. I FOTOGRAFISË MARUBI	12,361
12	MUZEU K. I PËRGJIMEVE " SHTËPIA ME GJETHE"	9,420
TOTALI MUZE		206,838
1	KALAJA BERAT	74,019
2	KALAJA GJIROKATËR	76,666
3	KALAJA PORTOPALERMOS	29,718
4	KALAJA E KANINËS	1,019
5	KALAJA E HIMARËS	3,912
6	AMFITEATRI	12,730
7	MANASTIRI I 40 SHËNJTORËVE	409

8	MANASTIRI I MESOPOTAMIT	2,725
TOTALI KALA E MONUMENTE TE TJERE		201,198
1	PARKU KOMBËTAR BUTRINT	167,759
2	PARKUT ARKEOLOGJIK APOLONI	29,141
3	PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS	3,966
4	PARKU ARKEOLOGJIK SHKODËR	52,710
5	PARKU ARKEOLOGJIK LEZHË	2,640
6	PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA	1,182
7	PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM	1,832
8	PARKU ARKEOLOGJIK FINIQ	821
9	PARKU ARKEOLOGJIK ANTIGONE	1,023
TOTALI PARQE ARKEOLOGJIK		261,074
TOTALI NUMRI I VIZIOREVE		669,110

Tabela 6. Vizitorët në atraksionet kulturore (INSTAT)

3.TURIZMI NË ZONAT E MBROJTURA

Në vendin tonë ekziston sistemi i zonave të mbrojtura mjedisore, që mbulojnë mbi 460.000 ha dhe shtrihet në mbi 16% të territorit të vendit. Baza e sistemit të zonave të mbrojtura mjedisore konsiston kryesisht në 15 parqe kombëtare, disa rezervate natyrore të menaxhuara e peizazhe të mbrojtura, në të cilat gjenden vlerat më të mëdha natyrore dhe biodiversitetit në vend. Këto vitet e fundit (pas krijimit të Administratave të Zonave të Mbrojtura Mjedisore), tashmë vizitorët (turistët), të cilët janë pjesë e vizitave dhe ecjeve në natyrën shqiptare, kanë në shumicën e rasteve informacionin e duhur se po përshkojnë në territore të zonave të mbrojtura mjedisore. Ato në çdo rast marrin informacion të detajuar për resurset natyrore të zonës së mbrojtur mjedisore, për vendodhjen dhe vlerat e larta natyrore, kulturore, historike, biologjike e trashëgimore të tyre si; shpella, ujëvara, kanione, maja shkëmbore, shtigje kalimi, objekte kulti etj., që ka zona e mbrojtur. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim po bëjnë punonjësit e AdZM-ve (veçanërisht Rengers-at) në terren ku i orientojnë vizitorët (turistët), drejt këtyre pikave. Po kështu në ndihmë të tyre vijnë dhe tabelat e ndryshme informative e orientuese që janë vendosur në hyrje apo vende të dallueshme.

Kategoria/ ZM	Nr. Vizitorëve viti 2016	Nr. Vizitorëve viti 2017
Rezervë Natyrore Strikte	4500	4750
Park Kombëtar	714279	1.051.046
Monument Natyre	65.978	73.277


Park Natyror	175	40.130
Rezervat Natyror i Menaxhuar	8.146	118.633
Peisazh i Mbrojtur	368.650	754080
Gjithsej	1.161,728	2.041.916

Tabela 7. Vizitorët në Zonat e Mbrojtura (AKZM)

4 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA TURIZMI


Bazuar në raportin e bilancit të pagesave të Bankës së Shqipërisë, të dhënat statistikore në udhëtim dhe turizëm për vitin 2017 kanë qënë pozitive, si më poshtë:

- 1- Të ardhurat nga udhëtim / turizmi për këtë vit kanë shënuar një rritje prej 12% krahasuar me një vit më parë. Në shifra kjo rritje është nga 1.528 milion Euro në 1.708 milion Euro (grafik 3).



Grafik 2: Të ardhurat nga udhëtimet/turizmi për vitet 2014-2017. (Burimi: Banka e Shqipërisë)

- 2- Përsa i përket kohëqëndrimit mesatar për jorezidentët, shifrat tregojnë se numri i netë qëndrimit për arsye personale është i njëjtë me vitin 2016 pra 5.8 netë mesatarisht, ndërsa për arsye biznesi ky numër është 4.3 netë po i njëjtë me mesateren e vitit të shkuar. Llogaritjet për vizitorët jorezidentë tregojnë se netëqëndrimet në shqipëri gjatë 2017 kapin një vlerë prej 26.824,434 netë. Shohim një ulje të moderuar të netëqëndrimeve krahasuar me vitin 2016.



Grafik 3: Përpunoi MTM

- 3- Shpenzimet mesatare ditore për vitin 2017 për jo rezidentët kur qëllimi i udhëtimit është biznesi, shpenzimet ditore kapin vlerën 121 euro në ditë, ndërsa vlera e shpenzimeve ditore për jorezidentët, që deklarojnë se qëllimi i vizitës në Shqipëri është personal arrin mesatarisht vlerën 94 Euro në ditë.


4.1 KONTRIBUTI I INDUSTRIJË SË TURIZMIT

Analiza e World Travel & Tourism Council na jep një panoramë më të qartë të kontributit që jep industria e udhëtimit dhe turizmit në ekonominë e vendit tonë, si në lidhje me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) ashtu dhe në lidhje me punësimin.

4.1.1 KONTRIBUTI DIREKT NË PBB

Paraqet të ardhurat që gjenerohen nga industritë që kanë lidhje direkte me turistët, duke përfshirë këtu hotelet, agjencitë e udhëtimit, linjat ajrore dhe shërbime të tjera të transportit të pasagjerëve, si dhe aktivitetin e industrisë së shërbimit ushqimor dhe të argëtimit, të cilat merren direkt me turistët.

Gjatë vitit 2017 kontributi direkt i turizmit në PBB e vendit tonë ka qënë 134.1 miliard Lekë, duke zënë kështu 8.5% në PBB të vendit. Në krahasim me një vit më parë ky kontribut është rritur me 6.4 miliard Lekë. Në grafikun e mëposhtëm jepet trendi rritës i kontributit direkt të industrisë së udhëtimit dhe turizmit në Prodhimin e Brendshëm Bruto në tre vitet e fundit:




Grafik 4: Përpunoi MTM

4.1.2 KONTRIBUTI TOTAL NË PBB

Paraqet PBB të gjeneruar direkte nga sektori i udhëtimeve dhe turizmit së bashku me impaktin e tij më të gjërë, që vjen nga investimet.


Gjatë vitit 2017 kontributi total i turizmit në PBB e vendit tonë ka qënë 414.2 miliard Lekë, duke zënë kështu 26.2 % në PBB të vendit. Në krahasim me një vit më parë ky kontribut është rritur me 21.2 miliard Lekë. Grafiku më poshtë jep rritjen në tre vitet e fundit kontributi në total të kësaj fushe në PBB.



Grafik 5: Përpunoi MTM

4.1.3 KONTRIBUTI DIREKT NË PUNËSIM

Paraqet numrin e vendeve të punës të gjeneruara direkt nga industria e udhëtimeve dhe turizmit. Gjatë vitit 2017 industria e turizmit dhe udhëtimeve ka gjeneruar në mënyrë direkte 93,500 vende pune, duke zënë kështu 7.7% në punësimin total. Në krahasim me një vit më parë, janë shtuar 8,000 vende pune më shumë. Në grafikun e mëposhtme paraqitet ky tregues për vitet 2015 – 2017:



Grafik 6: Përpunoi MTM

4.1.4 KONTRIBUTI TOTAL NË PUNËSIM

Paraqet numrin e vendeve të punës të gjeneruara nga industria e udhëtimeve dhe turizmit në mënyrë direkte dhe indirekte, duke përfshirë këtu dhe impaktin e gjërë që vjen nga investimet. Gjatë vitit 2017 industria e turizmit dhe udhëtimeve ka gjeneruar, në total, 291,500 vende pune, duke zënë kështu 24.1% të punësimit në total. Në krahasim me një vit më parë, janë shtuar 24,500 vende pune më shumë.

